



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2208 prot.

Tiranë, më 08.10.2025

**NJOFTIM PËR POZICION VAKANT “MAGAZINIER” NË DREJTORINË E
NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 393, datë 23.11.2020, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas shpall në ambjente të dukshme në godinën e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, njoftimin për personat e interesuar për pozicionin:

Magaznier 1 (një), Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

- **Kategoria e pagës:** Klasa V (sipas VKM nr. 326, datë 31.05.2023, i ndryshuar)
- **Lloji i punës:** Punë me kohë të plotë (8 orë në ditë, me afat të caktuar deri në kthimin në punë nga leja e barrë lindjes e punonjësës së magazinës)

Detyrat kryesore:

1. Merr pjesë në administrimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e magazinës;
2. Përgatist kushtet dhe specifikimet teknike për procedurat e magazinimit të mallrave, si dhe daljeve të të gjithë produkteve që kanë nën përgjegjësi;
3. Siguron pranimin dhe lëvrimin e mallrave, magazinimin e tyre sipas kontratës;
4. Kontrollon mirëmbajtjen e mallrave dhe materialeve të tjera në magazinë sipas kushteve dhe standardeve teknike;
5. Kryen detyra të tjera të dhëna nga eprorët.

I. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati:

1. Të jetë shtetas shqiptar;

2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe në të folur dhe të shkruar;
4. Të jetë në kushtet shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrave përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Të ketë minimalisht arsimin të mesëm;
7. Të ketë aftësi të mira komunikuese;
8. Të jetë i aftë të menaxhojnë situata të paparashikuara.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

1. Kërkesë për aplikim për pozicionin;
2. Diplomë e arsimit të mesëm/të lartë;
3. Librezë pune (të gjitha fletët që vërtetojnë eksperiencën e punës);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi ose nëpërmjet postës zyrtare në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas me adresë rr. "Jordan Misja", Njësia Administrative nr. 9, Godina 3, Tiranë, deri në datën **21.10.2025**.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

(në mungesë)

**(DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE
ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE)**

